

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Skenari i fundit! A do ta pranojë Kurti Hashim Thaçin president? - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/skenari-i-fundit-a-do-ta-pranoje-kurti-hashim-thacin-president/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:39:02 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 07:36:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	52ded85d0c768f7ef9adb5812d084dcbb91ac6162c9ee0402cc99f2ecb95c709
TEKSTI	1625dd512ab3de89551062edc66c89de208898096dff037e2477f00508371bd3
PAMJA	756ec119ed6f259c12bd3835f31fcde966c8368fcbf1b4b6550b2cabadf9fe22

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6996716b96fda4bded0c3107619004ee43a462b56482322a5ea92e03a7112c3a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9887a58f034e5892caf63e36ccbe81dcf86c1b224001923b84c66783530d965e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6996716b96fda4bded0c3107619004ee43a462b56482322a5ea92e03a7112c3a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.


Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

SHBA Erion Veliaj Donald Trump Bekim Sejdiu Kanada

EURONEWS NOW ME THIMI SAMARXHIUN | KOSOVË

Skenari i fundit! A do ta pranojë Kurti Hashim Thaçinin president?



15 Shtator 2026 | 09:36

I ftuar në Euronews Albania me gazetarin Thimi Samarxhiu, profesor Klejd Këllici u shpreh se nuk beson që Hashim Thaçi do të jetë kandidat për president të Kosovës apo që Albin Kurti do ta propozonte atë për këtë post.

Sipas tij, zgjidhja e krizave institucionale në Kosovë duhet të bëhet përmes mirëkuptimit dhe jo duke imponuar figura me ngarkesë të fortë simbolike apo politike. Këllici theksoi se edhe nëse Thaçi del i pafajshëm nga procesi gjyqësor, e udhës sipas tij do të ishte tërheqja e tij nga skena politike, pasi një vendim pozitiv do të provonte pastërtinë e luftës dhe do të përmbylte me dinjitet trajektoren e tij.

“Nuk besoj që do të jetë Hashim Thaçi kandidat për president. Nuk e besoj që Albin Kurti të propozojë Hashim Thaçinin për president. Problemi në Kosovë është ky, që nuk duhet që një krizë institucionale të zgjidhet me simbole më tepër sesa të zgjidhet nga mirëkuptimi.

Për mua, jo, nuk do të ishte as e mundur dhe as e dëshirueshme në kuptimin e asaj që kam përshtypjen që, të paktën për zotin Thaçi, në rast se do të dilte nga ky proces i pafajshëm, do të ishte e udhës që të tërhiqej nga skena politike. Jo fort për frikën apo përballjen me procese të ngjashme e kështu me radhë, por me idenë që, në fund të ditës, kjo trajektorja e tij politike mbyllej me një vendim i cili do të provonte jo vetëm pafajësinë, por do të provonte dhe pastërtinë e luftës në Kosovë.

Thaçit do t'i kërkohej që t'i kundërvihej apo të përballej me zotin Kurti, dhe unë e kam thënë gjithmonë që nuk mundet një parti që është në mazhorancë të pranojë një president Republike, pra të pranojë një kundërshtar politik si president Republike, sepse, sikurse kërkohej nga opozita një kandidat i cili të ruajë balancën institucionale, ashtu do të kërkohej edhe nga opozita një president i cili duhet të ruajë dhe distancë të barabartë mes subjekteve politike.

Dhe kam përshtypjen që nuk e garanton këtë as zoti Thaçi, as zoti Veseli, nuk e garantonte këtë as Vjosa Osmani. Në fund të ditës duhet të kuptohet që, meqë zgjedhja e presidentit po kthehet në atë mollën e sherrit ose në elementin i cili e fut në krizë sistemin politik në Kosovë, atëherë me të vërtetë duhet gjetur një personazh politik i cili ka disa karakteristika.

Për mua, zoti Sejdiu këtë karakteristikë e përmbushte; si zoti Sejdiu ka dhe 20 të tjerë në Kosovë. Kam përshtypjen që e udhës do të ishte më mirë inkorporimi i një kandidati për president Republike që nuk ka gjithë atë ngarkesë politike, pasi jam i bindur që do t'i kërkohej nikërisht konfrontimi me zotin Kurti” u shpreh ai.

LAJMI I FUNDIT

09:32 **GJKKO shpall vendimin për dosjen Revanshi, ja sa vite burg dënohet Durim Bami**

09:27 **AfD arrin për herë të parë në 30% në sondazhe: CDU në krizë**

09:22 **Si vendos familja mbretërore britanike për shkollimin e fëmijëve? William dhe Kate thyejnë një traditë**

SHPËRNDAJE

ARTIKULLIN

09:07 **Zbulohet “mega-Toka” misterioze, planeti 23.5 herë më masiv se Toka që sfidon shkencëtarët**

09:00 **Kina shton kontrollin, rregulla e reja kufizojnë udhëtimet dhe daljet nga vendi**

08:54 **Incident në Detin Baltik, fregata ruse lëshon flakadanë drejt helikopterit danez**

TESTIM

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

EURONEWS NOW ME THIMI SAMARXHIUN | KOSOVË | RAJONI

Hoti: Serbia po refuzon të japë informacionet për fatin e babait tim

Ministri për Familje dhe Mirëqenie Sociale, Andin Hoti, ka deklaruar në një intervistë për Euronews Albania me moderatorin Thimi Samarxhiu se mungesa e bashkëpunimit nga...

16:24 | 29/07/2026

AKTUALITET | EURONEWS NOW ME THIMI SAMARXHIUN | SPORT | VENDI | VIDEO

Lojërat Mesdhetare, peshëngritësi Briken Calja: Synoj t'i sjell dy medalje ari Shqipërisë

Peshëngritësi Briken Calja në një intervistë në Euronews Albania me Thimi Samarxhiu ka folur lidhur me eksperiencën e tij në Bundesligën gjermane, përgatitjet fizike dhe...

15:44 | 29/07/2026

AKTUALITET | EURONEWS NOW ME THIMI SAMARXHIUN | LAJMI KRYESOR | VENDI

Fati i Ervin Matës! Artan Hoxha: Në Brazil drejtësia është e shtrenjtë

Gazetari Artan Hoxha ka qenë i ftuar këtë të martë në edicionin informativ me Thimi Samarxhiun në Euronews Albania. Hoxha ka folur për rastin e...

16:38 | 28/07/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Punësimi

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.